



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 88, DATË 12 : 12 :2024

“PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË ME QËLLIM SHPËRBLIMIN E PUNONJËSVE MBËSHTETËS”.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 12.12.2024 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për përdorimin e fondit të veçantë me qëllim shpërblimin e punonjësve mbështetës”. Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit nr 09. datë 23.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, VKM-së nr 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar, VKB-së nr 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024”, i ndryshuar, VKB-së nr 107, datë 14.12.2023 “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të bashkisë Gjirokastrë për vitin 2024”, i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit të veçantë për shpërbilimin e punonjësve mbështetës si;
Shpërblimi për sektorin e rrugëve rurale pranë Shërbimeve Komunitare dhe Utilitare të jetë në masën 10,000 lek.
Shpërblimi për sektorin e mirëmbajtjes pranë Shërbimeve Komunitare dhe Utilitare të jetë në masën 10,000 lek
Shpërblimi për sektorin e ndriçimit pranë Shërbimeve Komunitare dhe Utilitare të jetë në masën 10,000 lek
Shpërblimi për sektorin e pastrimit të qytetit pranë Shërbimeve Komunitare dhe Utilitare të jetë në masën 10,000 lek
Shpërblimi për sektorin e pastrimit të njësive administrative pranë Shërbimeve Komunitare dhe Utilitare të jetë në masën 10,000 lek
Shpërblimi për sektorin e gjelbërimit pranë Shërbimeve Komunitare dhe Utilitare të jetë në masën 10,000 lek
Shpërblimi për sektorin e transportit pranë Shërbimeve Komunitare dhe Utilitare të jetë në masën 10,000 lek
Shpërblimi për sektorin e aerodromit pranë Shërbimeve Komunitare dhe Utilitare të jetë në masën 10,000 lek



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

- Shpërblimi për punonjësit mbështetës "manovrator" pranë Agjencisë së Bujqësisë Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit të jetë në masën 10,000 lek
1. Programet e financimit të jenë programet V452AAA, V626AAA, V644AAA, V510AAA, V424AAA.
 2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
 3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj

